



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
*Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës*  
*Izborni Panel za Žalbe i Predstavke*

**Anr.740/2021**

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevi kryesues, Kymete Kicaj dhe Ferki Xheferi anëtarë, duke vendosur lidhur me apelet e paraqitura të subjektit politik Lëvizja për Goren – PG, lidhur me anulimin e votave të ardhura për kuvendin komunal për Komunën e Dragashit, nga Shtetet, Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Republika e Malit të Zi, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura me datë 17 tetor 2021, për Kuvend Komunal, në seancën e panelit të mbajtur, me datë 07.11.2021, mori këtë:

## **V E N D I M**

**Refuzohen të pabazuara** Apelet Anr.740/2021, Anr.905/2021 dhe Anr.978/2021 të subjektit politik Lëvizja për Goren – PG, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, me të cilën ka kërkuar anulimin e votave të ardhura për kuvendin komunal për Komunën e Dragashit, nga Shtetet Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Republika e Malit të Zi.

## **A r s y e t i m**

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelet Anr.740/2021, Anr.905/2021 dhe Anr.978/2021 të subjektit politik Lëvizja për Goren – PG, me të cilën ndër të tjera pretendon se duhet të anulohen votat e ardhura nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Republika e Malit të Zi. Në bazë të pretendimeve të bashkëqytetarëve tanë që kanë vendbanim të përhershëm në Luksenburg, Zvicër, Austri, Bosnje dhe Hercegovinë dhe Serbi, kemi konstatuar se dikush nga partia politike Vakrat ka keqpërdorur dokumentet e tyre personale dhe të drejtën e votës në favor të partisë së cekur politike nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Republika e Malit të Zi, përmes postës ka dërguar material votimi. Në këtë mënyrë zyrtari

i partisë së lartcekur ka kryer vepër penale dhe ka keqpërdorur të dhënat personale të qytetarëve, të cilët jetojnë në vendet e përmendura dhe të cilat nuk kanë pasur asnjë kontakt me Maqedoninë e Veriut dhe Mali Zi. Gjithashtu thekson se individ nga Luksenburgu dhe Zvicra gjithashtu kanë raportuar keqpërdorime në Prokurorin e Shtetit të Republikë së Kosovës. Gjithashtu në listën e votuesve që votojnë nga Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi, janë persona që nuk jetojnë më, njëri prej tyre është Fikrija Bajmak, e cila ka votuar nga Mali i Zi, ndërsa e njëjta ka jetuar dhe ka vdekur në Shkup. Prandaj kërkojmë nga PZAP, që të anulohen votat nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Malit të Zi, pasi që të njëjtat janë të falsifikuara.

KQZ në kërkesën për përgjigje ka bashkangjitur bazën e të dhënave të KQZ-së për votuesit jashtë Kosovës të cilët kanë aplikuar sukseshëm për të votuar për Komunën e Dragashit. Gjithashtu ka theksuar se numri total i votuesve jashtë Kosovës për këtë komunë është 1090, ndërsa kanë votuar (kanë dërguar pako me fletëvotime) 679 votues.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, dhe në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

#### **Apeli është i pa bazuar**

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se, Subjekti Politik Lëvizja për Goren – PG, kërkon anulimin e votave të ardhura për kuvendin komunal për Komunën e Dragashit, nga Shtetet Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Republika e Malit të Zi. Paneli pas shqyrtimit të apelit erdhi në përfundim se apeli i ushtruar nga Subjekti Politik Lëvizja për Goren – PG, është i pa bazuar.

Paneli, vlerëson se parashtruesi i apelit në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse se votat për Kuvend Komunal për Komunën e Dragashit të ardhura nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Republika e Malit të Zi, janë manipuluar apo të njëjtat vota janë dërguar në mënyrë të orkestruar nga individ të caktuar ashtu sic pretendon apeluasi. Në rastin konkret apeluasi nuk ka arritur të dëshmojë me asnjë provë pretendimet e tij, se presonat e pretenduar në apel nuk janë votues, por për ta ka votuar dikush tjetër. I njëjti vetëm ka përshkruar emrat e votuesve në apel, por prej tyre nuk ka siguruar ndonjë deklaratë

apo dëshmi tjetër që do të vërtetonte pretendimet se në emër të tyre ka votuar dikush tjetër. Përndryshe në listën e votuesve mund të jetë edhe dikush që ka vdekur, por ajo listë nuk mund të korrigjohet apo të ndryshohet nga PZAP, nga se është listë që vjen nga Agjencia e Regjistrimit Civil të Kosovës. Andaj në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk munda të konstatoj se ka pasur manipulime me votat e ardhura nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Republika e Malit të Zi, ashtu siç pretendon ankuesi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete dhe të njëjtat janë vetëm pretendime dhe nuk argumentohen me asnjë provë.

Paneli vlerësoi se apeli i parashtruar, nuk është bazuar në dëshmi të qarta dhe bindëse ashtu siç përcaktohet në nenin 117 par.3, të LZP-së, pasi që nga shkresat e lëndës nuk mund të vërtetohet se ka ndodhur ndonjë shkelje me votat e ardhura nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Republika e Malit të Zi.

Ky vendim i PZAP-së, në kuptim të nenit 120 paragrafi 5 të LZP-së, është pa paragjykim ndaj ndonjë sanksionimi penal që mund të pasojë, pasi që vendimet e PZAP-së, janë vendime administrative, dhe në asnjë rast nuk e paragjykon çështjen për zhvillimin e një procedure tjetër.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë e në kuptim të neneve 115 paragrafi 1, 117 dhe 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
A.nr.740/2021 më datën 07.11.2021**

**Kryesuesi i Panelit  
Adnan Konushevc**



***Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.***